

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXVI, nr. 8334  
E martë, 7 korrik 2026  
Çmimi 0.50 €

**Balla takon Hoxhajn:  
Procesi në Hagë po zgjatet  
pa asnjë provë kundër  
komandantëve të UÇK-së**



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## LV-ja THOTË SE I KA VOTAT PËR QEVERINË, KËRKON KONSENSUS PËR PRESIDENTIN



Lëvizja Vetëvendosje tha se i ka siguruar votat për formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve të 7 qershorit dhe se do të kërkojë konsensus me partitë e tjera për zgjedhjen e presidentit, proces që dështoi muaj më parë dhe e

çoi vendin në zgjedhje të parakohshme. "Sa i përket qeverisë, ne i kemi votat e nevojshme. Prandaj, menjëherë pas konstituimit të Kuvendit pa humbur kohë duhet të vazhdojmë me procedurën për votimin e qeverisë, ndërsa

brenda afateve kushtetuese do të angazhohemi edhe për arritjen e konsensusit rreth zgjedhjes së presidentit/es", ka thënë ish-shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Arbërie Nagavci

**"TRENI KA IKUR": A KA ENDE RRUGË PËR KOSOVËN DREJT BE-së?**



**KOSOVA SEKUESTRON ASETË NË VLERË PREJ 1 MILION EUROSH TË NJË RRJETI TË TRAFIKIMIT TË DROGËS**



**SA TË SIGURTA JANË OBJEKTET BANESORE NË KOSOVË?**

**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

### SPORT



**GRANIT XHAKA MBETET TE SUNDERLANDI, DO TA UDHËHEQË EKIPIN NË PREMIERË LIGË DHE EVROPË**

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
[info@kolegjibiznesi.com](mailto:info@kolegjibiznesi.com)  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## BE-ja DËNON AKTIVITETET DESTABILIZUESE TË RUSISË NË BALLKANIN PERËNDIMOR

**BRUKSEL, 6 KORRIK** - Bashkimi Evropian tha se i kundërshton aktivitetet destabilizuese të Rusisë në Ballkanin Perëndimor dhe shtoi se marrëdhëniet me Rusinë nuk mund të vazhdojnë si zakonisht përdërisa regjimi i Vladimir Putinit vazhdon agresionin ndaj Ukrainës. Duke iu përgjigjur një pyetje lidhur me vazhdimin e bashkëpunimit ndërmjet policisë së entitetit të Republikës Sërpska dhe Moskës, Komisioni Evropian i tha Radios Evropa e Lirë se entitetet në Bosnjë-Hercegovinë kanë të drejtë të zhvillojnë bashkëpunim ndërkombëtar në fushat për të cilat janë përgjegjëse, por se duhet t'i përmbahen plotësisht Kushtetutës së Bosnjë-Hercegovinës dhe vendimeve të institucioneve

shtetërore. "Politika e jashtme në Bosnjë-Hercegovinë është kompetencë ekskluzive e shtetit, ndërsa entitetet kanë detyrim kushtetues t'i ndihmojnë institucionet shtetërore në përmbushjen e obligimeve të tyre", thuhet në përgjigjen e Komisionit Evropian. Ministri i Punëve të Brendshme i entitetit të Republikës Sërpska, Zhelko Budimir, nënshkroi më 23 qershor në Moskë një memorandum bashkëpunimi me Oleg Baranovin, shefin e Drejtorisë Kryesore të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Federatës Ruse për qytetin e Moskës i cili është i sanksionuar nga Bashkimi Evropian. Me këtë u vazhdua bashkëpunimi i vendosur më shumë se dhjetë vjet më parë, i



cili parasheh shkëmbimin e informatave, trajnime profesionale si dhe bashkëpunim në luftën kundër terrorizmit dhe formave të tjera të kriminalitetit. Teksti i memorandumit të ri nuk është bërë publik.

Nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës Sërpska i thanë Radios Evropa e Lirë se ai "i konkretizon më tej format e bashkëpunimit në fushën e aftësisht profesional, shkëmbimit të përvojave dhe realizimit të trajnimeve të

përbashkëta".

Parlamenti Evropian miratoi më 17 qershor një rezolutë për Bosnjë-Hercegovinë, në të cilën dënoi bashkëpunimin e autoriteteve të Republikës Sërpska me zyrtarë rusë që gjenden nën sanksione ndërkombëtare.

Në rezolutë u theksua se marrëdhëniet e tilla përbëjnë rrezik për sigurinë dhe stabilitetin e Bosnjë-Hercegovinës.

Bosnjë-Hercegovina u është bashkuar zyrtarisht sanksioneve të Bashkimit Evropian kundër Rusisë, por zbatimi i tyre kundërshtohet nga politikanët e Republikës Sërpska, të udhëhequr nga Millorad Dodik, president i partisë në pushtet, Aleanca e Socialdemokratëve të Pavarur.

## TRUMPI BISEDON ME ZELENSKYN DHE PUTININ, MES NGËRÇIT PËR UKRAINËN

**UASHINGTON, 6 KORRIK** - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky dhe Kremlinin njoftuan se presidenti Donald Trump zhvilloi biseda të ndara me udhëheqësit e Ukrainës dhe Rusisë, ndërsa përpjekjet për t'i dhënë fund luftës mbeten në ngërç, me Kievin dhe Moskën që vazhdojnë të jenë të bllokuar për çështje kyç. Bisedat u zhvilluan më 4 korrik, në ditën kur Shtetet e Bashkuara shënuan 250-vjetorin e pavarësisë së tyre. Megjithatë nuk pati ndonjë reagim të menjëhershëm nga Shtëpia e Bardhë lidhur me këto biseda, si Zelensky ashtu edhe këshilltari për politikë të jashtme i presidentit rus Vladimir Putin, Yury Ushakov, thanë se Trumpi mbetet i gatshëm t'i vazhdojë përpjekjet e tij ndërmjetësuese për t'i dhënë fund luftës në Ukrainë, e cila tashmë ka hyrë thellë në vitin e saj të pestë. "Ekziston një mundësi reale për t'i dhënë fund kësaj lufte dhe vendosmëria e Amerikës është vendimtare", shkroi Zelensky në rrjetin social X, pas asaj që e përshkroi si një bisedë "shumë të mirë" me Trumpin. Zelensky tha, gjithashtu, se e kishte informuar presidentin amerikan për zhvillimet më të fundit në fushëbetë të Ukrainës dhe njoftoi se të dy udhëheqësit ranë dakord t'i



"vazhdojnë diskutimet" për një zgjidhje të mundshme të konfliktit gjatë samitit të NATO-s, që do të mbahet javën e ardhshme në Ankara. Në muajt e fundit Kievi ka shtuar fushatën e sulmeve me rreze të mesme dhe të gjatë, duke shkaktuar mungesa të karburantit në mbarë Rusinë, gjë që ka detyruar të paktën 17 rajone të vendosin kufizime të detyrueshme për shitjen e benzinës dhe naftës. Më 4 korrik dronët ukrainas goditën terminalin e naftës në Shën Petersburg - një qendër e rëndësishme e

furnizimit me karburant në Detin Baltik - si dhe infrastrukturën portuale aty pranë. Autoritetet ruse thanë se mbrojtja ajrore e zbrapsi sulmin dhe raportuan vetëm dëme të vogla, ndërsa Ukraina tha se sulmet kishin në shënjestër infrastrukturën strategjike energjetike. Me mungesat e karburantit që po nxisin pakënaqësi te qytetarët rusë, të cilët deri tani kishin qenë kryesisht të paprekur nga lufta e plotë e vendit të tyre kundër Ukrainës, Kremlinin është

përpjekur gjithnjë e më shumë ta zhvendosë vëmendjen te ato që i paraqet si suksese në fushëbetë. Sipas Ushakovit, gjatë bisedës "90-minutëshe", Putini i paraqiti Trumpit versionin e tij për zhvillimet në front, duke e informuar presidentin amerikan për ofensivën tokësore ruse në rajonin lindor ukrainas të Donjeckut. Një ditë para bisedave me Trumpin, Rusia dhe Ukraina bënë pretendime kundërthënëse për zhvillimet në front, me Moskën që këmbënguli se kishte marrë

nën kontroll qytetin kyç të rajonit, Kostyantynivka, ndërsa Kievi e hodhi poshtë këtë pretendim.

Trumpi "edhe një herë konfirmoi gatishmërinë e tij për të punuar drejt përfundimit të shpejtë të luftimeve dhe gjetjes së zgjidhjeve për tejkalimin e krizës", tha Ushakov pas bisedës së Putinit me presidentin amerikan. Megjithatë, ai shtoi se Putini i tha Trumpit se Moska vazhdon të kërkojë "një zgjidhje politike dhe diplomatike të konfliktit, duke marrë parasysh qasjen themelore të Rusisë".

Pavarësisht prej përpjekjeve diplomatike të udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara që kur Trumpi u rikthye në Shtëpinë e Bardhë në janar të vitit 2025, Kievi dhe Moska vazhdojnë të jenë larg njëri-tjetrit sa iu përket kushteve për negociatë.

Gjatë vitit 2026, ndërsa Uashingtoni është përqendruar në luftën me Iranin, ka pasur gjithashtu pak përparim drejt uljes së intensitetit të luftimeve.

Kremlini ka vazhduar të mbajë qëndrim të ashpër dhe nuk ka ofruar asnjë kompromis lidhur me kërkesën e tij për kontroll të plotë mbi Donbasin, që përfshin rajonet e Donjeckut dhe Luhanskut në lindje të Ukrainës.

# LV-ja THOTË SE I KA VOTAT PËR QEVERINË, KËRKON KONSENSUS PËR PRESIDENTIN

PRISHTINË, 6 KORRIK - Lëvizja Vetëvendosje tha se i ka siguruar votat për formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve të 7 qershorit dhe se do të kërkojë konsensus me partitë e tjera për zgjedhjen e presidentit, proces që dështoi muaj më parë dhe e çoi vendin në zgjedhje të parakohshme. "Sa i përket qeverisë ne i kemi votat e nevojshme. Prandaj, menjëherë pas konstituimit të Kuvendit pa humbur kohë duhet të vazhdojmë me procedurën për votimin e qeverisë, ndërsa brenda afateve kushtetuese do të angazhohemi edhe për arritjen e konsensusit rreth zgjedhjes së presidentit/es", tha për "Radio Evropa e Lirë" ish-shefja e grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Arbërie Nagavci. LV-ja e kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, është fituese e zgjedhjeve të parakohshme të 7 qershorit me 47.13 për qind të votave apo 53 mandate në Kuvendin prej 120 vendesh.

Për zgjedhjen e qeverisë kërkohet shumica e thjeshtë prej 61 votash - pra LV-ja do të mund ta formonte një ekzekutiv me përkrahjen e partive pakicë joserbe - të cilat e kanë mbështetur edhe ekzekutivin aktual. Megjithatë, për presidentin kërkohet pjesëmarrja në votim në dy rundet e para të të paktën 80 deputetëve. Mospajtimet për zgjedhjen e presidentit çuan në zgjedhjet e parakohshme të 7 qershorit. Sipas Nagavcit, LV-ja do "të bëjë gjithçka" që është në mandatin e saj që të arrihen votat e nevojshme për zgjedhjen e presidentit të ri. "Andaj, është e nevojshme që deputetët, të cilët kanë fituar besimin e qytetarëve, të jenë në nivelin e përgjegjësive dhe ta zgjedhim presidentin/en, në mënyrë që ta tejkalojmë bllokadën në të cilën ndodhemi, të shmangim edhe një palë zgjedhje dhe të vazhdojmë puna me kompetenca të plota në të gjitha institucionet", shprehet Nagavci.

Kosova është me ushtrues detyre të presidentit që nga prilli, kur Vjosa Osmanit i përfundoi mandati pesëvjeçar kushtetues. Ndërkohë, partitë janë në pritje të certifikimit të rezultateve për t'i nisur konsultimet për formimin e institucioneve të reja. Aktualisht, Gjykata Supreme po trajton disa ankesa dhe ka afat deri të martën që t'i shqyrtojë ato, ndërsa Komisioni Qendror i Zgjedhjeve po pret vendimet e saj para se të vazhdojë me certifikimin e rezultateve.

Duke folur për këto takime mes partive, Nagavci thekson se kreu



i partisë, Albin Kurti do të udhëheqë këtë proces dhe do t'i zhvillojë ato "me synimin për ta gjetur zgjidhjen më të mirë për tejkalimin e situatës".

## "LV-ja nuk është e gatshme për kompromis të gjerë politik"

Por, politologu Dritëro Arifi e interpreton këtë qëndrim si shenjë se LV-ja nuk është e gatshme për kompromis të gjerë politik. "Mendoj se nëse shkohet me këtë logjikën ku nuk ka asnjë negociatë mbi ndërtimin e dëgjave pozitive, rezultati do të jetë pak a shumë siç ka qenë vitin e kaluar. Pra, deklarata e Nagavcit është sinjali se ata nuk janë të gatshëm të bashkëqeverisin vetëm ta zgjedhin një president çfarëdo qoftë ai ose ajo. Pra i bie nën urdhrat e LV-së", thotë Arifi.

LV-ja kërkon që vendi të ketë një president konsensual dhe muaj më parë propozoi edhe dy figura nga shoqëria civile, Feride Rushitin dhe Hatixhe Hoxha. Por, për shkak të mosarritjes së një marrëveshjeje me partitë opozitare, kandidaturat e LV-së për president nuk arritën t'i merrnin votat e nevojshme. Lidhur me përpjekjet për zgjedhjen e presidentit, Arifi thotë se deklarata e Nagavcit është "pa logjikë, pa përmbajtje, është puro politikë populiste", teksa thekson se parti të ndryshme kanë dalë me kushte të caktuara për bashkëpunim me LV-në e Kurtit.

## Cilat janë qëndrimet e partive?

"Radio Evropa e Lirë" u ka

dërguar pyetje Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) lidhur me konsultimet për formimin e institucioneve, por deri në publikimin e këtij artikulli nuk ka marrë përgjigje. Kreu i PDK-së, Bedri Hamza, një ditë pas zgjedhjeve deklaroi se fuqia e dytë më e madhe politike është e hapur për bisedime me të gjitha partitë, pa përjashtuar as LV-në. "Mendoj se për të pasur institucione shpejt dhe të qëndrueshme, duhet të ketë marrëveshje politike qysh tash, ende pa filluar konstituimi i Kuvendit, formimi i Qeverisë dhe pastaj zgjedhja e presidentit", tha ai. Ditë më parë ai tha se para se të flitet për bashkëpunim të mundshëm qeverisës janë një sërë temash, sikurse pagat dhe pensionet, kapacitetet energjetike, gazi amerikan, anëtarësimi i Kosovës në Bashkimin Evropian, që do të duhen të trajtohen me partinë fituese.

Nga LDK-ja, e cila në zgjedhje garoi me Vjosa Osmanit si kandidate për presidente - janë vendosur disa parakushte për një marrëveshje për krijimin e institucioneve të reja.

Kreu i kësaj partie, Lumir Abdixhiku, në një intervistë dhënë së voni për Klan Kosovën, tha se orientimi strategjik, përfshirë gazin amerikan "janë parakushti i ekzistencës politike" të LDK-së. Ai tha se duhet të flitet për projekte e parime qeverisëse si dhe për orientimin e Kosovës në katër vjetët e ardhshëm dhe më pas të mund të flitet për pozita.

Abdixhiku tha se për partinë e tij, që të merret vesh për presidentin, jetike mbetet që fillimisht të merren vesh për orientimin që do të ketë shteti. "Para se të merremi vesh për presidentin, duhet të merremi vesh për orientimin e Kosovës, për politikën strategjike të sigurisë, për politikën zhvillimore dhe natyrën se si e zhvillojmë demokracinë në Kosovë", tha ai.

Ndërkaq Aleanca ka paraqitur gjashtë kushte në këmbim të mbështetjes për krijimin e institucioneve të reja.

Kreu i kësaj partie, Adrian Gjini, ndër të tjera ka përmendur kushtin që Kosova ta pranojë projektin e gazit amerikan, ndërtimin e një termocentrali me thëngjill dhe disa kushte të tjera që kanë të bëjnë me ekonominë. "Duke e kuptuar logjikën se si ka operuar kjo qeveri, asnjë nga ato kushte zoti Kurti nuk do t'i marrë për bazë sepse ajo më pas është interferim në bashkëqeverisje. Këta nuk duan bashkëqeverisje po duan vetëm të merren vesh për presidentin", thotë politologu Arifi duke komentuar kushtet e paraqitura nga partitë opozitare. Sipas tij, "nuk ka parti normale opozitare që ta japë mbështetjen blanko për presidentin pa pasur transformim dhe ndryshim në politikën qeverisëse".

Qeveria në detyrë po përballet me thirrje nga Ambasada Amerikane, partitë opozitare dhe odat ekonomike që të bëhet pjesë e nismave rajonale të rrjetit të gazit të lëngshëm natyror (LNG), të mbështetura nga ShBA-ja. Megjithatë, deri më tani nga ekzekutivi nuk kanë dhënë

sinjale se janë të gatshëm të bëhen pjesë e këtyre nismave, teksa ministrja në detyrë e Ekonomisë, Artane Rizvanolli dhe kryeministri në detyrë, Albin Kurti, kanë përmendur idenë e gazifikimit të thëngjillit vendas.

Politologu Dritëro Arifi thotë se çështja e gazit amerikan do të duhej të ishte një nga kushtet e partive për krijimin e institucioneve, sepse "vetëm Kosova po mbetet jashtë këtij projekti të madh të ShBA-së. Kjo duhet të jetë një nga pikat e rëndësishme, por jo e vetme". Sipas tij, nëse partitë opozitare votojnë për presidentin dhe edhe nëse hipotetizohet LV-ja pranon ta rishqyrtojë idenë e gazit amerikan "ju nuk keni garanci kushtetuese, ligjore që ata do ta mbajnë fjalën e dhënë. Në këto gjashtë vjet ajo nuk e ka mbajtur asnjë premtim para dhe pas ardhjes në pushtet".

Nëse partitë nuk merren vesh për presidentin, vendi rrezikon të shkojë ërësh në zgjedhje. Ato do të ishin të katërtat që nga shkurti i vitit 2025. Sipas Arifit, nuk ka një klimë apo përpjekje për ndërtimin e një klime pozitive që vendi të dalë nga kjo bllokadë. Sipas rezultateve përfundimtare, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) i ka fituar 19.44 për qind, apo 22 ulëse në zgjedhjet e 7 qershorit, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) 16.69 për qind, apo 18 ulëse dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) - që së voni ka vendosur të përdorë vetëm emrin Aleanca - 6.74 për qind, apo shtatë mandate.



## 'TRENI KA IKUR': A KA ENDE RRUGË PËR KOSOVËN DREJT BE-së?

Tre vjet e gjysmë pasi dorëzoi aplikimin për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Kosova vazhdon të presë që kërkesa e saj ta kalojë hapin e parë procedural. Ndërsa zgjerimi është rikthyer në qendër të agjendës së BE-së, perspektiva evropiane e Kosovës mbetet e bllokuar. Çfarë e mban peng procesin dhe a ka ende rrugë për ta zhbllokuar?

**PRISHTINË, 6 KORRIK** - Kur Irlanda mori Presidencën e Këshillit të Bashkimit Evropian më 1 korrik, zgjerimin e vendosi në mesin e prioritetëve kryesorë për gjashtë muajt e ardhshëm. Megjithatë, në programin e saj, nuk ka asnjë referencë të veçantë për Kosovën. A është kjo vetëm një mungesë simbolike apo një tregues i "vendit" që Kosova zë sot në agjendën e zgjerimit të BE-së? Në përgjigjen që i dha Radios Evropa e Lirë, Presidenca irlandeze sqaroi se mbështetja përparimin e të gjitha vendeve candidate dhe candidate potenciale, përfshirë Kosovën, drejt anëtarësimit në BE. Por, e shoqëroi këtë mbështetje me një formulim të dëgjuar shpesh në Bruksel: përparimi do të varet nga kushtet që duhet të përmbushen dhe nga zbatimi i reformave të nevojshme. Prapa këtij qëndrimi diplomatik fshihet

një realitet shumë më kompleks për Kosovën.

### Një proces i bllokuar që në hapin e parë

Redaktori i Radios Evropa e Lirë për çështjet evropiane, Rikard Jozwiak, thotë se Kosova, aktualisht, nuk është në mesin e prioritetëve të zgjerimit të Bashkimit Evropian. Kur Irlanda flet për zgjerimin, sipas tij, fokusi është te vendet që tashmë kanë avancuar më shumë në procesin e anëtarësimit, si Mali i Zi dhe Shqipëria, por edhe tek Ukraina dhe Moldavia, të cilat, pas agresionit rus në Ukrainë, kanë fituar rëndësi të re strategjike për BE-në. "Kosova ka ngecur në zgjerim që kur ka dorëzuar kërkesën e saj për anëtarësim në fund të vitit 2022, dhe nuk pres ndonjë

lëvizje as në gjashtë muajt e ardhshëm", thotë Jozwiak. Sipas procedurave të BE-së, është presidenca e Këshillit të BE-së ajo që vendos nëse një aplikim futet në shqyrtim. Kosova e dorëzoi kërkesën e saj më 15 dhjetor 2022, në ditët e fundit të Presidencës çeke. Por, asnjë nga presidencat që pasuan, nuk e shtyu përpara. Si rezultat, aplikimi vazhdon të mos kalojë as fazën e parë formale: shqyrtimin nga Këshilli dhe dërgimin në Komisionin Evropian për vlerësim. Jozwiak thotë se pengesat nuk lidhen me presidencën e radhës, por me mungesën e konsensusit politik brenda vetë Bashkimit Evropian. "Presidenca e fundit që provoi të testonte gatishmërinë e Këshillit për t'ia përcjellë aplikimin e Kosovës Komisionit Evropian, ishte Suedia, në vitin 2023. Që atëherë, askush nuk e ka ndërmarrë një hap të tillë", thotë Jozwiak. Ai shton se nuk ka asnjë shenjë se pesë shtetet anëtare që nuk e njohin Kosovën - Spanja, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Qiproja - kanë ndryshuar qëndrimin e tyre. Për këtë arsye, sipas tij, Irlanda mund të arrijë shpejt në përfundimin se nuk ekziston

mbështetja e nevojshme politike për ta çuar përpara aplikimin e Kosovës dhe, rrjedhimisht, të mos e hapë fare këtë çështje në Këshillin e BE-së. Radio Evropa e Lirë kërkoi edhe qëndrimin e Qeverisë së Kosovës lidhur me pritjet nga Presidenca irlandeze dhe hapat që synon të ndërmarrë për avancimin e procesit të integritit evropian, por deri në publikimin e këtij materiali nuk mori përgjigje. Këtë javë në Prishtinë u mbajt takimi i Komitetit të Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, ku BE-ja kërkoi përshpejtimin e reformave, veçanërisht në administratën publike, sundimin e ligjit, lirinë e shprehjes dhe mbrojtjen e të drejtave themelore, përfshirë ato të komuniteteve joshumicë. Qeveria e Kosovës, nga ana e saj, riafirmoi përkushtimin për zbatimin e obligimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA).

### Përtej reformave të Kosovës

Ngecja e Kosovës në rrugën drejt Bashkimit Evropian, sipas

njohësit të politikës së zgjerimit në Iniciativën Evropiane për Stabilitet (ESI), Adnan Qerimagiq, nuk mund t'i atribuohet vetëm mungesës së reformave apo zhvillimeve politike në vend. Sipas tij, përgjegjësi mban edhe vetë Bashkimi Evropian, i cili ende nuk e ka ndërmarrë as hapin e parë procedural për shqyrtimin e aplikimit të Kosovës për anëtarësim. Qerimagiq argumenton se BE-ja ka dëshmuar edhe më herët se mund të gjejë zgjidhje juridike për ta avancuar marrëdhënien me Kosovën, pavarësisht faktit se pesë shtete anëtare nuk e njohin pavarësinë e saj. Si shembull ai përmend Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, për të cilën u gjet një formulë ligjore që mundësoi hyrjen e saj në fuqi. "Një qasje e ngjashme mund të zbatohet edhe për ta çuar përpara aplikimin e Kosovës për anëtarësim", thotë Qerimagiq për Radion Evropa e Lirë. Pengesa nuk është vetëm procedural, sipas profesorit në Universitetin e Gracit, Florian Bieber. Ai thotë se Bashkimi Evropian e ka lidhur përparimin e Kosovës në procesin e integritit me dialogun për

## BALLA TAKON HOXHAJN: PROCESI NË HAGË PO ZGJATET PA ASNJË PROVË KUNDËR KOMANDANTËVE TË UÇK-së

PRISHTINË, 6 KORRIK - Kryetari i grupit parlamentar i PS-së, Taulant Balla, ka pritur në takim ish-ministrin e Jashtëm, deputetin e zgjedhur të PDK-së, Enver Hoxhaj. Ata diskutuan për procesin gjyqësorë në Hagë dhe marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. "Mirëprita në Kuvendin e Shqipërisë Enver Hoxhaj, anëtar i Parlamentit të Kosovës, ish-kryetar i PDK dhe ish-

ministër i Jashtëm i Kosovës. Procesi i tejzgjatur pa asnjë provë kundër komandantëve të UÇK-së në Hagë, progresi i Shqipërisë në rrugën e anëtarësimit në BE, nevoja për statusin e vendit kandidat në BE për Kosovën, Samiti i kësaj jave i NATO-s, çështje të sigurisë dhe ndërhyrjet e huaja malinje në rajonin tonë ishin ndër çështjet kryesore të bisedës", ka shkruar Balla në "Facebook".



normalizimin e marrëdhënies me Serbinë - një proces që, sipas tij, prej kohësh ka humbur momentumin. "Në këtë pikë, dialogu ka të bëjë vetëm me menaxhimin e stabilitetit, jo me ndonjë zgjidhje. Për rrjedhojë, vështirë se mund të ketë përparim në perspektivën evropiane të Kosovës, derisa Bashkimi Evropian ose të heqë dorë nga kushtëzimi i saj me dialogun, ose derisa vetë dialogu të marrë një drejtim më serioz", thotë Bieber për Radion Evropa e Lirë. Sipas tij, kjo do të thotë se edhe një presidencë e Këshillit të BE-së që e ka zgjerimin në mesin e prioriteteve, ka pak hapësirë për të ndryshuar dinamikën në raport me Kosovën.

Në rastin më të mirë, thotë ai, Presidenca irlandeze mund të nxisë një diskutim mbi mënyrën se si është ndërtuar procesi i zgjerimit për Kosovën dhe nëse perspektiva e saj evropiane duhet të vazhdojë të kushtëzohet nga dialogu me Serbinë.

Por, edhe për këtë ai sheh pak gjasa.

Bieber vlerëson se mungesa e institucioneve të konsoliduara në Kosovë, por edhe raportet e tensionuara që Qeveria në detyret e Albin Kurtit ka krijuar me disa shtete kyç të Bashkimit Evropian, kanë zbehur gatishmërinë politike në Bruksel për të ndryshuar qasjen ndaj Kosovës. "Kështu që, nuk shoh shumë gatishmëri nga ana e BE-së për të ndryshuar dinamikën dhe nuk mendoj se Irlanda është në gjendje të bëjë shumë në këtë drejtim", thotë Bieber. Një klimë e tillë politike përkon me një periudhë të zgjatuar paqëndrueshmërie institucionale në Kosovë.

Për më shumë se një vit e gjysmë, vendi është përballur me ngërç politik, pasi tri procese zgjedhore, të mbajtura brenda 16 muajve, nuk kanë prodhuar një

shumicë të qëndrueshme parlamentare. Aktualisht, Kosova pret formimin e institucioneve të reja pas zgjedhjeve të 7 qershorit, në të cilat Lëvizja Vetëvendosje, e udhëhequr nga Albin Kurti, doli sërish forca e parë politike.

### Çfarë mund të bëjë Kosova?

Jozwiak thotë se hapësira për ta afruar Kosovën me Bashkimin Evropian, në fazën aktuale të zgjerimit, është e kufizuar. "Mendoj se treni për këtë ka ikur", thotë ai. Por, veçon një çështje që, sipas tij, vazhdon të ketë peshë të madhe në institucionet evropiane: përparimin drejt themelimit të Asociacionit të komunave me shumicë serbe. "Ky ka qenë gjithmonë një kusht kyç i BE-së dhe mbetet i tillë edhe tani, edhe pse momentum, sigurisht, nuk është më aty kur bëhet fjalë për dialogun", thotë Jozwiak. Asociacioni i komunave me shumicë serbe buron nga Marrëveshja e Brukselit e vitit 2013, e arritur në dialogun Kosovë - Serbi, të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Ai parashihet si një mekanizëm bashkëpunimi ndërmjet komunave me shumicë serbe në Kosovë.

Ndër vite, BE-ja ka këmbëngulur se themelimi i tij është një nga obligimet kryesore të Kosovës në kuadër të dialogut, por procesi ka mbetur i bllokuar, për shkak të mosmarrëveshjeve rreth kompetencave të Asociacionit dhe shqetësimeve se ai mund të cenojë funksionalitetin e shtetit.

Për më tepër, edhe vetë dialogu mes Kosovës dhe Serbisë është në një periudhë stagnimi.

Takimi i fundit në nivel të lartë është mbajtur në shtator të vitit 2023, pak para sulmit të

armatosur në Banjskë.

Që prej atëherë, përpjekjet e Bashkimit Evropian për ta rikthyer procesin në binarë nuk kanë prodhuar ndonjë përparim domethënës.

### Ku qëndron Kosova në raport me rajonin?

Ndërsa procesi i integritetit të Kosovës ka mbetur praktikisht i ngrirë, pjesa më e madhe e vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor kanë shënuar, në shkallë të ndryshme, përparim në rrugën drejt BE-së.

Mali i Zi mbetet kandidati më i avancuar, me të gjithë kapitujt e negociatave të hapur dhe shumicën e tyre tashmë të mbyllur përkohësisht. "Vendi i Malit të Zi në Bashkimin Evropian tani po merr formë", ka thënë komisionarja për Zgjerim e BE-së, Marta Kos, gjatë një vizite në Podgoricë në muajin maj.

Nëse anëtarësimi i tij materializohet në vitin 2028, siç synohet, ai do ta shënonte zgjerimin e parë të Bashkimit Evropian në 15 vjet, që nga pranimiti i Kroacisë në vitin 2013.

Shqipëria po zhvillon negociatat e anëtarësimit, ndërsa Maqedonia e Veriut, megjithëse i ka nisur zyrtarisht ato, përballet me bllokada politike, sidomos nga Bullgaria, për hapjen e kapitujve të parë.

Bosnjë-Hercegovina mori dritën e gjelbër për hapjen e negociatave të anëtarësimit në vitin 2024, ndërsa Serbia, ndonëse negociacion me BE-në që nga viti 2014, ka mbetur prej vitesh pa hapur kapitujt e rinj, për shkak të mungesës së reformave dhe mosharm-onizimit me politikën e jashtme të BE-së, veçanërisht ndaj Rusisë. Në kontrast me to, Kosova mbetet i vetmi vend i Ballkanit Perëndimor që nuk ka as status kandidati për anëtarësim në BE.

## 'BËNI DIÇKA PËR THAÇIN', SALI BISLIMI APELON PAS TELEFONATËS ME EURODEPUTETIN, KRYETAR TË KOMISIONIT PËR ÇËSHTJE JURIDIKE NË PARLAMENTIN EVROPIAN

PRISHTINË, 6 KORRIK - Veprimtari shqiptar në Zvicër, Sali Bislimi, ka bërë me dije se ka zhvilluar një bisedë telefonike me eurodeputetin liberal-demokrat Ilhan Kyuchyuk, njëherësh kryetar i Komisionit për Çështje Juridike në Parlamentin Evropian. Përmes një postimi në rrjetet sociale, Bislimi ka thënë se i ka kërkuar eurodeputetit të ndërmarrë hapa lidhur me procesin gjyqësor ndaj ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi. "Ju

lutem bëni diçka për presidentin Thaçi. Është turp për demokracinë evropiane me standarde të dyfishta për Kosovën. Si është e mundur gjashtë vite në paraburgim, si një burg pa gjyq. Nuk ngrihet kredibiliteti i gjykatës duke krijuar dhimbje dhe padrejtësi", ka shkruar Bislimi. Ai e ka cilësuar të papranueshme zgjatjen e paraburgimit të Thaçit, duke kërkuar trajtim të drejtë dhe respektim të standardeve të drejtësisë.



# AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS (ASHAK): KUR NJË AKADEMI HUMB MISIONIN E SAJ



Shkruan: Shyqyri HAXHA

Lexoni Ligjin për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Pastaj bëni vetëm një pyetje: a po e përmbush ASHAK misionin që vetë ligji ia ka besuar?

Sipas ligjit, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK) është institucioni më i lartë shkencor dhe artistik i Republikës së Kosovës. Misioni i saj është të promovojë dhe zhvillojë shkencën, artin dhe kulturën, të

nxisë kërkimin shkencor, të ofrojë ekspertizë për çështje me rëndësi kombëtare dhe të kontribuojë në zhvillimin intelektual, ekonomik dhe shoqëror të vendit.

Ky nuk është një përshkrim ceremonial. Është një detyrim ligjor dhe moral. ASHAK nuk është krijuar për të ekzistuar si simbol, por për të qenë mendja strategjike e shtetit. Për të prodhuar ide, për të ndikuar në politikën publike, për të

udhëhequr kërkimin shkencor dhe për ta lidhur Kosovën me botën akademike.

E shkruaj këtë jo si politikan, jo si komentator dhe as si dikush që kërkon përfitim personal. E shkruaj si profesor në një nga universitetet më të mira të Mbretërisë së Bashkuar, si akademik me titullin më të lartë akademik britanik, me mbi 300 publikime shkencore dhe rreth 20 patenta ndërkombëtare. Kam kaluar dekada duke zhvilluar kërkim shkencor, duke fituar fonde konkurruese dhe duke bashkëpunuar me universitetet dhe institutet më prestigjioze në botë. Pikërisht për këtë arsye nuk mund të rri anash dhe të hesht kur shoh se institucioni që duhet të përfaqësojë majën e shkencës në Kosovë nuk po arrin të dëshmojë ndikimin që i kërkon ligji dhe që e pret shoqëria.

Kjo nuk është një sulm ndaj individëve. Është një thirrje për reflektim ndaj një institucioni që financohet nga qytetarët dhe që duhet t'u japë llogari qytetarëve.

Çdo vit, shteti investon mbi një milion euro në ASHAK. Kjo do të ishte plotësisht e justifikueshme nëse qytetarët do të shihnin rezultate të prekshme: projekte madhore kërkimore, studime që ndikojnë në politikën shtetërore, partneritete me universitetet më të mira në botë, fonde ndërkombëtare të fituara në konkurrencë, mbështetje për studiuesit e rinj dhe një zë të fuqishëm shkencor në debatet më të rëndësishme të vendit. Por pyetja mbetet: a po ndodh kjo?

Sa reforma shtetërore janë ndërtuar mbi ekspertizën e ASHAK-ut? Sa strategji kombëtare janë hartuar mbi studimet e saj? Sa projekte evropiane me ndikim ka

udhëhequr? Sa fonde konkurruese ndërkombëtare ka fituar? Sa shkencëtarë të rinj ka ndihmuar të ndërtojnë karrierë? Këto nuk janë pyetje retorike. Janë pyetje që burojnë drejtpërdrejt nga misioni që ligji ia ka dhënë këtij institucioni.

Kur një institucion financohet nga taksat e qytetarëve, përgjegjësia e tij nuk është vetëm të funksionojë sipas procedurave. Përgjegjësia është të prodhojë vlerë. Ligjshmëria nuk është e njëjtë me performancën. Një buxhet mund të shpenzohet sipas rregullave, por kjo nuk do të thotë automatikisht se ai ka prodhuar rezultatet që shoqëria pret.

Po aq shqetësues është perceptimi i vazhdueshëm për mungesë meritokracie dhe për ndikime politike ose grupore në jetën e institucionit. Edhe kur këto mbeten perceptime dhe jo fakte të provuara, ato dëmtojnë besimin publik. Për një akademi kombëtare, besimi është po aq i rëndësishëm sa edhe prodhimi shkencor. Autoriteti akademik nuk buron nga titulli, por nga integriteti, transparenca dhe merita.

Kosova është një vend i vogël dhe me burime të kufizuara. Pikërisht për këtë arsye nuk ka luksin të mbajë institucione që nuk sfidojnë veten dhe nuk matin performancën e tyre sipas standardeve më të larta ndërkombëtare.

Ndërkohë, qindra profesorë dhe studiues shqiptarë në Mbretërinë e Bashkuar, Gjermani, Zvicër, Francë dhe Shtetet e Bashkuara drejtojnë laboratorë, fitojnë fonde milionëshe për kërkim, publikojnë në revistat më prestigjioze dhe udhëheqin konsorciume ndërkombëtare. Në disa raste, ndikimi shkencor

i një akademiku shqiptar në diasporë është më i madh se ai i një institucioni të tërë në Kosovë. Kjo nuk duhet të shihet si krahasim për të nënçmuar ASHAK-un, por si një mundësi e humbur. Pse ky potencial i jashtëzakonshëm nuk është bërë pjesë organike e akademisë kombëtare?

Një akademi moderne nuk mund të funksionojë me mentalitetin e institucioneve të mbyllura të shekullit të kaluar. Nuk mund të mbështetet vetëm në status, traditë apo tituj. Duhet të jetë konkurruese, transparente, e hapur ndaj brezave të rinj dhe e lidhur ngushtë me rrjetet më të avancuara shkencore në botë.

Shpesh ASHAK-u të krijon përshtypjen e një "traktori Ferguson" të vjetër dhe të amortizuar: për t'u ndezur duhet ta shtyjë dikush tjetër. Por Kosova nuk ka nevojë për një institucion që mezi vihet në lëvizje. Ka nevojë për një motor që e tërheq zhvillimin shkencor, ekonomik dhe shoqëror të vendit.

Prandaj debati nuk duhet të jetë nëse ASHAK duhet mbrojtur nga kritikantët. Debati duhet të jetë nëse ai po e përmbush misionin që ligji ia ka dhënë dhe nëse po e justifikon besimin dhe fondet që merr nga qytetarët.

Asnjë institucion publik nuk duhet të jetë i paprekshëm. Respekti fitohet me rezultate, jo me status. Tradita është e rëndësishme, por nuk mund të zëvendësojë performancën.

Nëse duam që Kosova të ndërtojë një ekonomi të dijës, atëherë akademia e saj kombëtare duhet të jetë lokomotiva e këtij transformimi. Nëse nuk është, atëherë reforma nuk është më çështje preference. Është një domosdoshmëri kombëtare.

## VAZHDOJNË OPERACIONET POLICORE NË ZUBIN POTOK, SËRISH ZBULOHEK SASI E MADHE ARMËSH DHE MUNICIONI

ZUBIN POTOK, 6 KORRIK - Policia e Kosovës në tri raste të ndara rreth orës 02:00, të datës 6 korrik, në shtëpi të pabanuara, ka gjetur dhe sekuestruar sasi të ndryshme municioni, armë dhe pajisje të dyshuara ushtarake. Në rastin e parë në objekt janë gjetur dhe konfiskuar 432 fishekë të kalibrit 7.62 mm si dhe 18 fishekë të kalibrit të panjohur. Lidhur me këtë rast është njoftuar prokurori kompetent dhe është inicuar procedura hetimore.

Në rastin e dytë policia ka gjetur dhe sekuestruar 204 fishekë të kalibrave të ndryshëm, 56 gëzhoja, një bajonetë, një maskë ushtarake si dhe tri pajisje ushtarake për ushqim.

Edhe për këtë rast është njoftuar prokuroria, e cila ka urdhëruar fillimin e hetimeve. Ndërsa në rastin e tretë janë konfiskuar një pushkë ajrore, 31 fishekë dhe disa para të vjetra me origjinë jugosllave. Edhe ky rast është duke u trajtuar nga njësitë relevante



policore në koordinim me prokurorinë.

Të gjitha rastet janë duke u hetuar për të sqaruar origjinën e armëve, municionit dhe pajisjeve të gjetura, si dhe për të identifikuar personat e mundshëm të përfshirë.

Këto nuk janë rastet e vetme, pasi kohëve të fundit Policia e Kosovës është duke hasur në një numër të shtuar të rasteve të ngjashme ku po zbulohen armë, municion dhe pajisje të ndryshme të dyshuara në lokacione të ndryshme.

# KOSOVA SEKUESTRON ASETE NË VLERË PREJ 1 MILION EUROSH TË NJË RRJETI TË TRAFIKIMIT TË DROGËS

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 KORRIK - Policia e Kosovës, me autorizim të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, më 30 qershor ka zhvilluar një operacion në Prishtinë dhe ka sekuestruar asete me vlerë 1 milion euro.

Operacioni është realizuar në kuadër të një hetimi mbi pastrimin transnacional të të ardhurave të nxjerra nga trafikimi i drogës, i realizuar nga autoritetet italiane dhe franceze, të koordinuara nga Eurojust dhe Eurojust, në bashkëpunim të ngushtë me

Prokurorinë Speciale dhe Policinë e Kosovës.

Analiza e materialit të sekuestruar gjatë hetimit, së bashku me informacionin e marrë nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës - Departamenti për Hetimin e Krimit të Organizuar në ekzekutimin e një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë juridike të paraqitur nga autoritetet gjyqësore italiane, i mundësoi hetuesve të identifikonin llogaritë bankare, interesat e biznesit, pasuritë e paluajtshme dhe automjetet me vlerë të lartë në pronësi të një çifti të martuar shtetas të Kosovës që banojnë në Itali.

Çifti, i cili është nën hetim penal në Itali me dyshimin për pastrim parash, u arrestua në Francë në shtator 2025. Policia kishte zbuluar më shumë se 56 kilogramë shufra ari dhe 2.5 milionë euro të fshehura brenda në ndarjeje të modifikuar të dy automjeteve. Po ashtu, po në shtator 2025 ishin sekuestruar të ardhura të tjera nga veprimet kriminale me vlerë më shumë se 30 milionë euro. Këto asete ishin të lidhura me një rrjet kriminal transnacional të angazhuar në pastrimin e të ardhurave të gjeneruara nga trafikimi i drogës në Francë nga individë të lidhur me



grupe kriminale në Francë. Sipas autoriteteve, konvertimi i parave të gatshme në ar shërbeu për një qëllim të dyfishtë: fshehjen e origjinës së paligjshme të të ardhurave kriminale dhe lehtësimin e fshehjes dhe transportit të tyre ndërkufitar, veçanërisht në Kosovë, Turqi dhe Marok. Në ekzekutimin e kërkesës për ndihmë të ndërsjellë ligjore, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës - Departamenti për Hetimin e Krimit të Organizuar, në koordinim të ngushtë me Policinë e Kosovës, ndërmori të gjitha masat e nevojshme procedurale dhe hetimore,

duke rezultuar në identifikimin, gjurmimin dhe sekuestrimin e aseteve brenda territorit të Republikës së Kosovës me një vlerë të vlerësuar prej afërsisht 1 milion eurosh. Eurojust dhe Eurojust ofruan mbështetje të konsiderueshme gjatë gjithë hetimit duke lehtësuar bashkëpunimin gjyqësor dhe operacional ndërkufitar midis autoriteteve italiane, franceze dhe atyre të Kosovës, të cilat kanë luajtur rol kyç në identifikimin, gjurmimin dhe sekuestrimin e aseteve kriminale në juridiksione të shumta.

## POPULLSIA E KOSOVËS PO PLAKET, ÇFARË PO NDIKON?



PRISHTINË, 6 KORRIK - Popullsia e Kosovës po përballet me një proces të theksuar plakjeje. Parashikimet tregojnë se moshja mesatare mund të arrijë deri në 49 vjeç në vitin 2060. Sipas Agjencisë të Statistikave të Kosovës, kjo lidhet me uljen e lindjeve dhe ndryshimeve demografike. Demografi Mehdi Gashi, në emisionin "Ora Shtatë" në "Klan Kosova", ka thënë se Kosova nuk përbëhet më nga popullsia më e re. "Jemi mësuar ta dëgjojmë se jemi popullsia më e re, por në fakt ka ndryshim vitet e fundit që nuk qëndron më ajo që dikur

veç ishte. Tregues tjetër shumë i saktë është edhe moshja mesatare, kur e krahasojmë me vitet më të hershme, Kosova e kishte 22-23 vjeç, tashmë është 33-34 vjeç", u shpreh Gashi. Nga ana tjetër, demografi Arjan Gjonçe ka theksuar se emigracioni është ndër faktorët kryesorë të ndryshimit të popullsisë. "Popullsia është dinamike dhe ndryshon, mund të ketë edhe kthime. Nëse ekonomia e Kosovës është e mirë, Kosova vazhdon të jetë një vend stabil, kjo mund të ndikojë që trendi i emigracionit të jetë

pozitiv. Është e vërtetë që Kosova po plakët, por ajo që është më e vërtetë, dhe e rëndësishme për ne, është se po plakët shpejt", u shpreh Gjonçe. Kurse sociologu Genc Xërxa përmendi edhe një faktor tjetër që ndikon në plakjen e popullsisë së Kosovës. Sipas tij, numri i lindjeve ka rënë që, sipas Xërxës, ndikon shumë në dinamikën e popullsisë së vendit. Ndërsa gazetari Vullnet Krasniqi deklaroi se zyrtarët e ASK-së në terren, siç thotë ai, janë të shqetësuar me trendin e shpejtë të plakjes së popullsisë.

## Maqedonci: Në vitin 2029 Ushtria e Kosovës do të jetë e gatshme për mbrojtjen e territorit

PRISHTINË, 6 KORRIK - Ministri në detyrë i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka deklaruar se deri në vitin 2029 Ushtria e Kosovës pritet të jetë e gatshme për mbrojtjen e territorit. Ai tha se vendi ndodhet në një fazë tranzicioni dhjetëvjeçar, i cili, sipas planifikimeve, përfundon në vitin 2028.

Maqedonci theksoi se gjatë kësaj periudhe janë tejkaluar disa objektiva të parashikuara si në aspektin e sasisë së pajisjeve ushtarake, po ashtu

edhe në llojet e armatimit. "Është aprovuar më 14 dhjetor 2018 nga Kuvendi. Gjatë kësaj faze kemi pasur një plan tranzicioni dhe tash jemi në përfundim të tij, i cili parashihet të mbyllet në vitin 2028. Investimet që kemi pasur kanë bërë që të tejkalojmë shumë nga objektivat, si në aspektin e pajisjeve, jo vetëm në sasi por edhe në llojet e armatimit, pasi kemi qenë të kufizuar në atë plan," ka thënë Maqedonci.

Ai shtoi se vendi është në fazën

përmbyllëse të ndërtimit të kapaciteteve operacionale dhe se objektivi është që në vitin 2029 të arrihet gatishmëria e plotë.

"Jemi në fund të procesit për arrijtjen e kapaciteteve operacionale. Ne planifikojmë që në vitin 2029 të kemi një forcë të gatshme për mbrojtjen e territorit, për mbështetjen e autoriteteve civile dhe për pjesëmarrje në misione ndërkombëtare", ka deklaruar ai në një intervistë për Euronews Albania.



## Sa të sigurtat janë objektet banesore në Kosovë?

**PRISHTINË, 6 KORRIK** - Mijëra objekte të reja banesore janë ndërtuar vitet e fundit në Kosovë, të përcjella me pikëpyetje se a i plotësojnë kushtet e sigurisë për banorët. Sipas dekanit të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin e Prishtinës, Florim Grajçevci, nuk ka kontroll të mjaftueshëm institucional rreth standardeve të ndërtimit.

Në podkastin pesë pyetje të "Radios Evropa e Lirë", ai thotë se duhet të bëhen ndryshime ligjore që ndërtimet në Kosovë të certifikohen nga nivele më të

larta institucionale. "Komunat, në përgjithësi, në Kosovë, në këtë aspekt kanë numër të vogël të stafit, dhe në asnjë mënyrë nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për të bërë kontrolle dhe inspektime nëpër objektet që ndërtohen. Arsyeja është e thjeshtë: ka shumë ndërtime dhe ka pak njerëz", shprehet Grajçevci.

Për këtë arsye ai propozon një model alternativ, ku institucionet akademike dhe profesionistët teknikë do të përfshiheshin në vlerësimin e projekteve.

Sa iu përket kushteve të

sigurisë në objektet e banimit kolektiv, Grajçevci thotë se ato shpesh nuk plotësohen nga ndërtuesit. "Alarmet nuk janë të mjaftueshme për efektin e sigurimit kundër zjarrit", thotë ai, duke sqaruar se alarmi vetëm paralajmëron për zjarr, por nuk e shuan atë. Sipas tij, në ndërtesa publike dhe kolektive, sistemet automatike të shuarjes së zjarrit, shkallët dhe daljet emergjente duhet të jenë të obligueshme, jo opcionale.

Për mangësitë dhe cilësinë e dobët të ndërtesave, Grajçevci thotë se përgjegjësia është



zinxhirore. "Prej projektuesit të ndërtuesit, te ai që e ka dhënë certifikatën për shfrytëzim", shprehet ai në 5 pyetje.

Në rastet kur qytetarët që duan të blejnë një banesë dhe

nuk dinë për cilësinë e objektit, ai sugjeron që ata të konsultojnë paraprakisht një inxhinier ndërtimi, për të parë nëse banesa ku planifikojnë të jetojnë përmbush standardet e sigurisë.

# ZULFAJ: ME SEPA-n, DIASPORA DHE BIZNESET DO TË KURSENIN RRETH 60 MILIONË EURO NGA KOSTOT E PAGESAVE

**PRISHTINË, 6 KORRIK** - Kryenegociatori i Kosovës me Bashkimin Evropian, Jeton Zulfaj, ka deklaruar se anëtarësimi i Kosovës në SEPA do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë për diasporën dhe bizneset, duke ulur kostot e remitancave dhe transaksioneve ndërkombëtare.

Në një intervistë në "Përballje Podcast" në Telegrafi.com, Zulfaj tha se Kosova kishte dërguar në Kuvend dy ligje që lidhen me SEPA-n, por vetëm njëri prej tyre ka kaluar. Sipas tij, bëhet fjalë për ligje të rëndësishme që lidhen me integrimin e Kosovës në Zonën Unike Evropiane të Pagesave, e njohur si SEPA. "U dërguan disa ligje, duke përfshirë edhe dy ligjet që ishin për SEPA-n. SEPA është zona për kryerjen e pagesave, Single European Payment Area, domethënë zona e vetme ose unike për kryerjen e pagesave", deklaroi Zulfaj shkruan Telegrafi.

Ai tha se përfshirja e Kosovës në SEPA do t'i ulte ndjeshëm kostot që sot i paguajnë qytetarët, diaspora dhe bizneset për dërgesa e



transaksione ndërkombëtare. "Te remitancat që dërgon diaspora dhe te transaksionet që kryejnë bizneset tona, Oda Ekonomike Gjermane llogarit se afër 60 milionë euro janë kostot, të cilat reduktohen në momentin kur bëhemi pjesë e SEPA-s", u shpreh ai.

Zulfaj tregoi se nga dy ligjet e dërguara në Kuvend, Ligji për Shërbimin e Pagesave ka kaluar, ndërsa ligji që lidhet me financimin e terrorizmit dhe shpëlarjen e parave nuk është miratuar. "Të dy ligjet shkuan në Kuvend dhe njëri kaloi, ai

për shërbimin e pagesave. Ky për financimin kundër terrorizmit dhe shpëlarjes së parave nuk kaloi", tha Zulfaj. Sipas tij, arsyetimi se ligji po kërkohej të kalonte me procedurë të shpejtë nuk qëndron, pasi Kuvendi nuk ishte duke funksionuar me ritëm të rregullt dhe koha për miratimin e reformave ishte e kufizuar. "Arsyetimi ishte i keq, se po kërkohej të kalojë me procedurë të shpejtë. Mirëpo në kohën kur Kuvendi nuk do të funksionojë dymbëdhjetë muaj, por vetëm një muaj,

sigurisht se gjërat duhet të përshpejtohen", deklaroi ai. Zulfaj tha se vonesat në miratimin e ligjeve të tilla ndikojnë edhe në humbjen e mjeteve nga Plani i Rritjes, pasi reformat janë të lidhura me afate të përcaktuara nga Bashkimi Evropian. "Nëse nuk duam që të humbim mjete nga Plani i Rritjes, gjërat duhet të përshpejtohen", u shpreh Zulfaj.

Ai shtoi se ngadalësimi në kryerjen e reformave duhet të lidhet me bllokadën në Kuvend, pasi shumë prej reformave kërkojnë miratim ligjor. "Mendoj që ngadalësimi në kryerjen e reformave duhet t'i adresohet shumë Kuvendit, bllokadës që ka ndodhur në Kuvend", tha ai.

### Çfarë është SEPA dhe si funksionon?

SEPA, apo Zona Unike Evropiane e Pagesave, është një mekanizëm evropian që synon t'i bëjë pagesat në euro ndërmjet shteteve pjesëmarrëse po aq të thjeshta, të

shpejta dhe të sigurtat sa pagesat brenda një vendi. Përmes SEPA-s, qytetarët dhe bizneset mund të dërgojnë ose pranojnë para në euro me kushte dhe standarde të unifikuara, pavarësisht nëse pagesa bëhet brenda shtetit apo drejt një vendi tjetër pjesëmarrës.

Në praktikë, SEPA funksionon përmes rregullave dhe standardeve të përbashkëta bankare për transfere, debitime direkte dhe pagesa të tjera në euro. Qëllimi është të ulen dallimet mes pagesave vendore dhe atyre ndërkufitare, duke i bërë transaksionet më efikase dhe më të lira për qytetarët, diasporën dhe bizneset.

Për Kosovën, përfshirja në SEPA do të ishte e rëndësishme sidomos për remitancat nga diaspora dhe pagesat ndërkombëtare të bizneseve. Nëse Kosova bëhet pjesë e këtij sistemi, dërgimi i parave dhe pagesat në euro drejt vendeve pjesëmarrëse do të mund të bëheshin me kosto më të ulëta dhe me procedura më të standardizuara.

## Fermerët e qumështit protestojnë në Prishtinë, derdhin qumështin para Ministrisë së Bujqësisë

**PRISHTINË, 6 KORRIK** - Fermerët e qumështit kanë protestuar të hënën pranë Ministrisë së Bujqësisë, duke shprehur pakënaqësinë e tyre ndaj politikave dhe gjendjes në sektorin e qumështit.

Protestuesit me traktorë para objektit të ministrisë kanë derdhur qumësht në hyrje të institucionit.

Fermerët kanë kërkuar që institucionet të ndërmarrin masa konkrete për mbrojtjen e prodhimit vendor dhe përmirësimin e kushteve për prodhuesit e qumështit.

Vendimi për organizimin e protestës është marrë nga Shoqata e Fermerëve Kosovarë të Qumështit, e cila e ka cilësuar protestën të domosdoshme pas ndërprerjes së grumbullimit të qumështit të freskët nga fermat, situatë që, sipas tyre, rrezikon seriozisht ekzistencën e shumë prodhuesve vendorë.

Protesta vjen edhe pas mbylljes së përkohshme të fabrikës së përpunimit të qumështit "Vita" në Istog pas një aksioni të autoriteteve.

Përmes protestës ata kërkojnë

që institucionet të ndërmarrin masa të menjëhershme për tejkalimin e krizës dhe kanë paraqitur tri kërkesa kryesore: rifillimin e menjëhershëm të grumbullimit të qumështit të freskët nga fermat; publikimin urgjent të rezultateve të analizave, në mënyrë që të hiqen dyshimet mbi cilësinë e produkteve vendore; rikthimin e çmimit të mëparshëm të qumështit, duke theksuar se ulja e çmimit po i çon shumë ferma drejt falimentimit.

Protesta është zhvilluar nën përcjelljen e Policisë së Kosovës.



# KUSH KOMANDON VËRTET NË IRAN

Kur ajatollahu Ali Khamenei qeveriste në Iran si udhëheqës suprem, ai ushtronte një pushtet absolut mbi të gjitha vendimet që lidhen me luftën, paqen dhe negociatat me Shtetet e Bashkuara. Djali i tij dhe pasardhësi, nuk e ka të njëjtin rol. Ajatollahu Mojtaba Khamenei është një figurë e pakapshme: që nga emërimi i tij në mars, nuk është shfaqur publikisht dhe nuk ka folur. Në vend të tij, vendimet kyçe për sigurinë, luftën dhe diplomacinë merren nga një grup i përbërë nga komandantë të Gardës Revolucionare Islamike dhe figura të tjera të afërta me ta. "Mojtaba e drejton vendin si të ishte drejtori i një bordi administrativ", thotë Abdolreza Davari, një politikan që ka qenë këshilltar i Mahmoud Ahmadinejadit gjatë presidencës së tij dhe e njuh Khamenein. "Ai mbështetet shumë të sugjerimet dhe orientimet e anëtarëve të këtij bordi; të gjitha vendimet merren kolektivisht", shton Davari në një intervistë telefonike nga Teherani. "Anëtarët e bordit janë gjeneralët."

Ky përshkrim i strukturës së re të pushtetit në Iran bazohet në intervista me gjashtë zyrtarë të lartë iranianë, dy ish-zyrtarë, dy persona të lidhur me Gardën Revolucionare, një klerik të rëndësishëm që njeh mirë dinamikën e brendshme të sistemit dhe tre persona pranë Khameneit. Nëntë të tjerë të lidhur me Gardën dhe qeverinë kontribuuan për të përshkruar strukturën e komandës. Të gjithë folën në kushte anonimite, për shkak të ndjeshmërisë së temave.

## Iran, frikë për sigurinë

Mojtaba Khamenei, i zgjedhur nga një këshill klerikësh të moshuar si udhëheqësi i ri suprem, është fshehur që nga 28 shkurti, kur forcat izraelite dhe amerikane bombarduan kompleksin ku jetonte babai i tij dhe ku banonte edhe ai me familjen. Përveç të atit, në sulm u vranë edhe gruaja dhe djali i tij. Sot është jashtëzakonisht e vështirë të kontaktohet me të; qasja është e kufizuar në një rreth shumë të ngushtë. Ai është i rrethuar kryesisht nga një ekip mjekësh dhe infermierësh që kujdesen për plagët e tij. As drejtuesit e Gardës Revolucionare dhe as zyrtarët e lartë qeveritarë nuk e vizitojnë, nga frika se Izraeli mund të gjurmtojë lëvizjet e tyre dhe ta vrasë. Presidenti Masoud Pezeshkian, që është edhe kardiokirurg, si dhe ministri i Shëndetësisë janë të përfshirë në trajtimin e tij. Edhe pse është plagosur rëndë, sipas katër zyrtarëve të lartë iranianë, Khamenei është mendërisht i kthjellët dhe aktiv. Ai është operuar tre herë në një këmbë dhe pret të vendosë një protezë. Ka kryer gjithashtu një ndërhyrje në dorë, nga e cila po rimer gradualisht veten. Fytyra dhe buzët i janë djegur rëndë, ndaj e ka të vështirë të flasë dhe në të ardhmen do të ketë nevojë për kirurgji plastike.

Ai nuk ka regjistruar asnjë mesazh video apo audio, sepse nuk dëshiron të shfaqet i dobët në fjalimin e tij të parë publik. Ka dhënë disa deklarata me shkrim, të publikuara online dhe të lexuara në televizionin shtetëror. Mesazhet për të shkruhen me dorë, vulosen në zarfe dhe dërgohen përmes një zinxhiri korrierësh të besuar, që udhëtojnë me makina dhe motoçikleta nëpër rrugë kryesore dhe dytësore deri në vendndodhjen e tij të fshehtë. Përgjigjet e tij kthehen në të njëjtin mënyrë.

Për shkak të shqetësimeve për sigurinë, plagëve dhe vështirësisë për t'u kontaktuar, Khamenei ua ka deleguar vendimmarrjen gjeneralëve, të paktën për momentin. Si fraksionet reformiste ashtu edhe ato më të ashpra vazhdojnë të marrin pjesë në diskutimet politike. Por analistët thonë se lidhjet e ngushta të Khameneit me ushtrinë, të krijuara gjatë luftës Iran-Irak, i kanë bërë ata forcën dominuese.

Presidenti i SHBA-së, Donald Trump, ka deklaruar se lufta dhe vrasja e disa figurave kyçe të sigurisë dhe liderëve iranianë kanë sjellë një "ndryshim regjimi" dhe se drejtuesit e rinj janë "më të arsyeshëm". Në realitet, Republika Islamike nuk është rëzuar. Sot pushteti është në duart e një strukture ushtarake të fortifikuar dhe të paepur, ndërsa ndikimi i klerikëve është në rënie. "Mojtaba nuk e ka ende kontrollin e plotë", shpjegon Sanam Vakil, drejtuese për Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut në Chatham House. "Ndoshta ka njëfarë respekti ndaj tij. Ai firmos ose është pjesë formale e strukturës vendimmarrëse. Por në këtë moment përballet me vendime të marra tashmë."

Në një fjalim televiziv më 18 prill, kryetari i parlamentit Mohammad Bagher Ghalibaf, ish-gjeneral i Gardës Revolucionare dhe negociator kryesor me SHBA-në në Pakistan, tha se propozimi amerikan për marrëveshjen bërthamore dhe planin e paqes, si dhe përgjigjja iraniane, i ishin paraqitur Khameneit dhe se mendimi i tij ishte marrë parasysh në vendimmarrje.

## Në Iran nuk ka kundërshtime

Trupi i Gardës së Revolucionit Islamik, i krijuar për të mbrojtur revolucionin islamik të vitit 1979, ka grumbulluar pushtet duke siguruar role të larta politike, përfshirje në sektorë kyç të industrisë, kontroll mbi operacionet e inteligjencës dhe duke u lidhur me grupe të armatosura në Lindjen e Mesme, që ndajnë armiqtësinë e Iranit ndaj Izraelit dhe Shteteve të Bashkuara. Por me Ali Khamenein në krye, Garda duhej ende t'i përmbahej vullnetit të tij si udhëheqës fetar dhe njëkohësisht komandant i përgjithshëm i forcave të



armatosura. Ai i forcoi dhe, me kalimin e kohës, ato u bënë një instrument dhe shtyllë e pushtetit të tij.

Vrasja e Khameneit në ditën e parë të luftës krijoi një boshllëk dhe një mundësi. Në betejën për pasardhës, Garda u reshtua me Mojtaba Khamenein, duke luajtur një rol vendimtar në emërimin e tij si udhëheqësi i tretë suprem i Iranit.

Garda ka shumë mjete për të ushtruar pushtetin. Komandanti i përgjithshëm është gjenerali Ahmad Vahidi. Gjenerali Mohammad Bagher Zolghadri, i emëruar së fundmi në krye të Këshillit të Lartë të Sigurisë Kombëtare, është një ish-komandant i Gardës i njohur për qëndrimet e ashpra. Gjenerali Yahya Rahim Safavi ka qenë këshilltari kryesor ushtarak si i Ali Khameneit, ashtu edhe i të birit. "Mojtaba nuk është suprem; mund të jetë një udhëheqës në letër, por jo suprem si i ati", thotë Ali Vaez, i cili ndjek Iranin në International Crisis Group dhe ka një rrjet të gjerë kontaktesh në vend. "Mojtaba është i varur nga Garda e Revolucionit, sepse pozicioni i tij dhe mbijetesja e sistemit varen prej tyre."

Zyrtarët e intervistuar thonë se gjeneralët e shohin luftën me SHBA-në dhe Izraelin si një kërcënim për mbijetesën e regjimit dhe, pas pesë javësh luftimesh të ashpra, besojnë se e kanë vënë nën kontroll. Në çdo moment ata kanë orientuar strategjinë dhe përdorimin e burimeve. Kanë tronditur ekonominë globale duke mbyllur Ngushticën e Hormuzit dhe kanë përdorur çdo fitore si levë për të mposhtur rivalët politikë brenda vendit.

Sipas disa zyrtarëve të mirëinformuar, presidenti dhe qeveria e tij janë lënë mënjanë dhe janë ftuar të merren vetëm me çështjet e brendshme, si sigurimi i ushqimeve dhe karburantit dhe funksionimi normal i vendit. Abbas Araghchi, shtojnë ata, është marginalizuar në negociatat që kishte zhvilluar me Shtetet e Bashkuara para luftës. Vendi e tij e ka zënë Mohammad Bagher Ghalibaf, kryetari i parlamentit.

Udhëheqësi i ri suprem është përshtatur me situatën, pothuajse pa kundërshtuar

vendimet e gjeneralëve, sipas burimeve. Ishin Gardianët ata që projektuan sulmet iraniane kundër Izraelit dhe shteteve të Gjirit Persik, si dhe mbylljen e ngushticës për trafikun detar. Ishin po ata që pranuan armëpushimin e përkohshëm dhe miratuan diplomacinë informale dhe negociatat e drejtpërdrejta me Uashingtonin. Ata zgjodhën Ghalibafin nga radhët e tyre për të udhëhequr bisedimet me zëvendëspresidentin amerikan JD Vance në Islamabad. Për herë të parë, disa gjeneralë të Gardës ishin pjesë e delegacionit iranian në negociatat me Shtetet e Bashkuara.

## Njerëzit e batalionit

Sipas zyrtarëve dhe tre personave të tjerë që e njohin Mojtaba Khamenein, qasja e tij e përmbajtur ndaj grupit lidhet pjesërisht me faktin se është i ri në rolin e udhëheqësit: i mungon pesha politike dhe prestigji fetar që e bënë të atin një figurë kaq të veçantë. Por kjo lidhet edhe me marrëdhëniet e tij të thella me ushtrinë.

Kur ishte 17 vjeç, Mojtaba Khamenei doli vullnetar për të luftuar në luftën Iran-Irak. Ai u caktua në një brigadë të Gardës Revolucionare të quajtur batalioni "Habib". Kjo përvojë la shenja, duke krijuar lidhje që zgjatën gjithë jetën. Me kalimin e kohës, shumë prej njerëzve të atij batalioni morën role të rëndësishme në ushtri dhe në shërbimet e fshehta. Khamenei përfundoi studimet në teologji, duke arritur gradën e ajatollahut (studiu dhe jurist i besimit shiit). Ai punonte në kompleksin e të atit, duke koordinuar operacionet ushtarake dhe të inteligjencës, një rol që forcoi lidhjet e tij me gjeneralët dhe drejtuesit e shërbimeve sekrete. Ndër miqtë e tij më të afërt nga batalioni "Habib" janë ish-shëfë i inteligjencës së Gardës, kleriku Hossein Taeb, dhe gjenerali Mohsen Rezaei, komandanti i tij në vitet '80. Edhe Mohammad Bagher Ghalibaf është një mik i vjetër.

Sipas burimeve, për vite me radhë Khamenei, Taeb dhe Ghalibaf takoheshin një herë në

javë për dreka të gjata pune në zyrat e ajatollahut, duke u bërë të njohur si "trekëndëshi i pushtetit". Kjo treshe u akuzua nga një klerik më i moderuar, Mehdi Karroubi, se kishte ndërhyrë në zgjedhjet presidenciale të vitit 2009, në të cilat ai ishte kandidat, duke manipuluar rezultatet në favor të presidentit në detyrë, Mahmoud Ahmadinejad. Karroubi humbi dhe rezultati i votimit shkaktoi muajt të tërë trazirash, protestash dhe dhune.

## Një mesazh për qytetarët

Fraksioni ekstremist, edhe pse jo dominues, është kundër çdo lëshimi, i bindur se nëse Irani vazhdon të luftojë, ai do të mposhtë Izraelin dhe Shtetet e Bashkuara. Mbështetësit e tij kanë mbushur rrugët, duke premtuar se do të sakrifkohen për Republikën Islamike. Kur Abbas Araghchi njoftoi në rrjetet sociale rihapjen e ngushticës, ata akuzuan ekipin negociator për tradhti.

Më radikalët mbështesin Saeed Jalilin, një kandidat presidencial ultrakonservator që është përjashtuar nga procesi vendimmarrës, por që vazhdon të ketë ndikim, edhe mbi televizionin shtetëror, i cili drejtohet nga vëllai i tij. Disa kanë kërkuar që Mojtaba Khamenei të japë një mesazh për të konfirmuar para qytetarëve se është në favor të negociatave me Uashingtonin. Gjatë një manifestimi në Teheran, turma brohoriste: "Komandant, na jep urdhrin dhe ne do ta ndjekim". Në mbrëmjen e 18 prillit, Mohammad Bagher Ghalibaf u shfaq në televizion për të siguruar se Khamenei ishte i përfshirë në vendimmarrje. Ai përdori një ton sfidues, por pragmatik, duke thënë se Irani ka arritur disa suksese ushtarake, por se ky është momenti për t'i shfrytëzuar këto arritje në negociatat diplomatike.

"Ndonjëherë shoh njerëzit tanë të thonë se i kemi shkatërruar", tha Ghalibaf. "Jo, nuk i kemi shkatërruar; këtë duhet ta kuptoni. Sukseset tona ushtarake nuk do të thonë se jemi më të fuqishëm se Shtetet e Bashkuara." Farnaz Fassihi - New York Times. Bota.al

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE 'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## KOK-u organizoi kursin për administratorë sportive

**PRISHTINË, 6 KORRIK** - Komiteti Olimpik i Kosovës përmes Akademisë Olimpikë, organizoi këtë fundjavë kursin për administratorë sportive, ku morën pjesë përfaqësues të federatave të mundjes, gjimnastikës, badmintonit, si dhe të federatave të tjera

sportive. Gjatë kursit pjesëmarrësit u njohën me procesin e hartimit të planeve strategjike për organizatat sportive si dhe diskutuan tema të ndryshme që lidhen me menaxhimin dhe administrimin në sport. Programi përfshiu punë në

grupe, prezantime dhe diskutime interaktive. Në përfundim të kursit pjesëmarrësit u pajisën me certifikata të lëshuara nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar. Ligjërues në këtë kurs ishin: Drejtori i Departamentit të

Sportit në Ministrinë e Sportit dhe Rinisë, Ibër Alaj (MEMOS XIX), anëtari i Komitetit Ekzekutiv të Komitetit Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare, Stavri Bello, si dhe koordinatori për edukim në Akademinë Olimpikë, Fitim Arifi.



## NIS PROGRAMI I LIGJËRATAVE PËR GJENERATËN E TRETË TË ZYRTARËVE VAR/AVAR TË FFK-së

**PRISHTINË, 6 KORRIK** - Ka nisur programi i ligjëratave për gjeneratën e tretë të zyrtarëve VAR/AVAR të Federatës së Futbollit të Kosovës, ku gjyqtarët dhe gjyqtarët asistentë do të ndjekin një proces të avancuar trajnimi për t'u certifikuar në përdorimin e sistemit VAR.

Programi do të zhvillohet në pesë module, duke kombinuar pjesën teorike dhe atë praktike sipas standardeve të përcaktuara nga FIFA. Në përfundim të këtij cikli

secili kandidat do t'i nënshtrohet procesit të certifikimit si VAR dhe AVAR, i cili do të realizohet gjatë ndeshjeve testuese që do të organizohen në fillim të muajit gusht para nisjes së edicionit të ri garave.

Federata e Futbollit e Kosovës vazhdon të investojë në zhvillimin profesional të referimit, duke dëshmuar përkushtimin e saj për rritjen e cilësisë dhe integritetit të garave. Që nga implementimi i sistemit VAR pesë vjet më parë,



futboli ynë ka bërë hapa të rëndësishëm në modernizimin e ndarjes së drejtësisë, ndërsa

edicioni garues 2026/27 do ta shënojë sezonin e gjashtë me radhë ku të gjitha ndeshjet e

Albi Mall Superligës si dhe një pjesë e ndeshjeve të Ligës së Parë, do të zhvillohen me asistencën e teknologjisë VAR. Përgatitja e gjeneratës së tretë të zyrtarëve VAR/AVAR është një tjetër dëshmi e përkushtimit të FFK-së për ta garantuar gjykim sa më profesional në fushën e gjelbër, duke investuar vazhdimisht në edukimin, zhvillimin dhe avancimin e kuadrove të referimit në përputhje me standardet më të larta evropiane.

## GRANIT XHAKA MBETET TE SUNDERLANDI, DO TA UDHËHEQË EKIPI NË PREMIERË LIGË DHE EVROPË

**PRISHTINË, 6 KORRIK** - Saga e transferimit të Granit Xhakës ka marrë fund. Mesfushori shqiptar me pasaportë zvicerane do ta vazhdojë karrierën te Sunderlandi, duke u dhënë fund spekulimeve që e lidhnin me një transferim te Chelsea.

Interesimi i klubit londinez ishte konkret, sidomos pas ardhjes së Xabi Alonso në stolin e Chelsea.

Trajneri spanjoll dëshironte të ribashkohej me Xhakën, me të cilin kishte bashkëpunuar me shumë sukses te Bayer Leverkuseni. Megjithatë, Sunderlandi nuk ishte i gatshëm të hiqte dorë nga një prej futbollistëve më të rëndësishëm të skuadrës.

Klubi anglez refuzoi ofertën e Chelsea dhe bëri të qartë se Xhaka nuk është në shitje. Mesfushori 33-vjeçar ka kontratë deri në verën e vitit

2028 dhe konsiderohet pjesë kyçe e projektit sportiv të Sunderlandit. Me këtë vendim tashmë është e qartë se Granit Xhaka do të mbetet edhe për të paktën një sezon në "Stadium of Light".

Ai do të vazhdojë të jetë lideri i padiskutueshëm i skuadrës, si në Premierë Ligë, ashtu edhe në garat evropiane, ku Sunderlandi synon të lërë gjurmë pas rikthimit në skenën kontinentale.

Për Sunderlandin, mbajtja e Xhakës është një fitore e madhe. Përvoja, karakteri dhe cilësitë e tij si lider kanë qenë vendimtare në ngritjen e ekipit dhe klubi nuk dëshiron ta humbasë futbollistin që konsiderohet zemra e mesfushës.

Ndërkohë Chelsea dhe Xabi Alonso do të duhet të kërkojnë alternativa të tjera për repartin e mesfushës, pasi një ribashkim me Granit Xhakën nuk do të



ndodhë këtë verë. Gjithçka tregon se sezoni i ardhshëm do ta gjejë Granit Xhakën sërish me fanellën e Sunderlandit, aty ku do të vazhdojë ta udhëheqë ekipin me përvojën, autoritetin dhe shpirtin e tij luftarak.

## Brazili konfirmon vendimin për të ardhmen e Carlo Ancelottit pas eliminimit befasues nga Kupa e Botës

**PRISHTINË, 6 KORRIK** - Federata Braziliene e Futbollit ka konfirmuar se Carlo Ancelotti do të vazhdojë të jetë përzgjedhës i kombëtares pavarësisht prej eliminimit të hershëm nga Kupa e Botës pas humbjes 2-1 ndaj Norvegjisë në fazën e 1/16 së finales. Sipas raportimeve të "Sky Sport Italia", drejtori ekzekutiv i përfaqësuesve të Brazilit, Rodrigo Caetano, ka bërë me dije se federata ka besim të plotë te tekniku italian dhe nuk ka në plan të bëjë ndryshime në stol.

Caetano theksoi se Brazili do ta vazhdojë projektin afatgjatë deri në Kupën e Botës 2030, duke shmangur ndryshimet e shpeshta të trajnerëve. "Brazili duhet të vazhdojë një cikël normal deri në Kupën e Botës 2030, me më shumë qetësi sesa ndryshimet e shpeshta të trajnerëve që kanë karakterizuar katër vitet e fundit". "Me trajnerin e konfirmuar për ciklin e



ardhshëm, do të jemi në gjendje ta fillojmë rindërtimin e ekipit në shtator. Pikërisht për këtë arsye, CBF do të bëjë të kundërtën e asaj që është bërë zakonisht. Federata tashmë ka fituar besim në punën e Ancelottit edhe para Kupës së Botës", deklaroi Caetano.

Edhe vetë Ancelotti kishte bërë me dije pas humbjes ndaj Norvegjisë se dëshiron të vazhdojë në krye të Brazilit, duke e cilësuar eliminimin si "fillimin e një cikli të ri" për pesë herë kampionët e botës.

Italiani ka kontratë me Brazilin deri në vitin 2030 dhe do ta udhëheqë procesin e rindërtimit të Seleçãos në vitet e ardhshme.

## "U përpoqa, tani ka marrë fund", Neymari largohet nga Brazili pas eliminimit nga Botërori

**PRISHTINË, 6 KORRIK** - Ylli brazilian i futbollit, Neymar, ka njoftuar tërheqjen nga Kombëtarja e Brazilit menjëherë pas eliminimit të ekipit nga Norvegjia me rezultatin 2-1 në fazën e 1/8 së

finales së Kupës së Botës. Pas ndeshjes Neymari konfirmoi se ky ishte takimi i tij i fundit me fanellën e kombëtares. "U përpoqa. Gjithçka nisi këtu, në MetLife Stadium, dhe këtu edhe përfundoi. Tani ka marrë

fund", deklaroi ai para gazetarëve. Sulmuesi shënoi golin e vetëm të Brazilit në këtë sfidë, duke e mbyllur karrierën e tij ndërkombëtare me një bilanc mbresëlënës prej 80 golash në

130 ndeshje si dhe 59 asistesh. Brazili nuk ka arritur ta fitojë Kupën e Botës që prej triumfit të vitit 2002, ndërsa largimi i Neymarit shënon fundin e një epoke për përfaqësuesen braziliane.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria –Vlada-Government*  
**MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT**  
**AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR**  
**AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE**  
**AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION**

Numër: 1144/1  
 Datë: 06.07.2026

## KONKURS

**Për plotësimin e vendeve të lira për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (X) në Qendrat e Kompetencës për vitin shkollor 2026/2027**

### 1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, në Gjinnaze dhe IAAP, për vitin shkollor 2026/27, mund të konkurrojnë nxënësit, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

### 2. Dokumentet e nevojshme për konkurim

Nxënësit për të konkuruar për regjistrim në klasën e X-të në IAAP, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikatën e lindjes.

### 1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për Gjinnaze dhe IAAP për vitin shkollor 2026/2027, bëhet më datën 7, 8 dhe 9 korrik 2026 në lokalet e shkollës amë, duke filluar nga ora 9:00-16:00

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 10.07.2026

Nxënësi i pakënaqur me rezultatin e publikuar, ka të drejtë ankese brenda (2) dy ditë pune, nga koha e shpalljes së rezultateve.

Ankesa parashtrrohet në drejtorinë e shkollës. Ankesat në shkollën e dytë behën në Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimit për të Rritur brenda (2) dy ditë pune, pas pranimit të përgjigjes nga shkolla.

### A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kritere:

- Suksesi nga shkollimi i obliguar (40%) 40 pikë**
- Suksesi nga lëndët prioritare nga shkollimi i obliguar (20%) 20 pikë**
- Numri i pikëve nga testi (40%) 40 pikë**

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë (100%), **100** pikë.

Kriteri i lëndëve prioritare nga suksese për gjinnaze dhe shkolla te mesme te mjekësisë është qe mesatarja e këtyre lëndëve të jetë minimum 4.00 (së pari llogaritet mesatarja e lëndëve veç e veç për klasat (6-9), pastaj mesatarja e mesatareve te atyre lëndëve).

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjinnaze dhe shkolla te mesme të mjekësisë është minimumi 40% e pikëve nga ato lëndë.

1. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 40 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

$$\text{Suksesi (kl.6 + kl.7 + kl.8 + kl.9)} \times 2 = 40 \text{ pikë max}$$

Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 20 pikë. mesatarja e lëndës (I) + mesatarja e lëndës (II) + mesatarja e lëndës (III) + mesatarja e lëndës (IV) = 20 pikë max

### Lëndët me prioritet në sukses sipas profileve në IAAP

- Shëndetësi, Bujqësi, Teknologji Ushqimore dhe Veterinari:**  
Biologji, Kimi, Fizikë Gjuhe shqipe dhe letërsi,
- Makineri, Elektroteknikë, TIK, Tekstil, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë, Komunikacion, Kimi — Teknologji, PTT:**

Matematikë, Informatikë, Fizikë, Gjuhë Shqipe dhe letërsi

- Ekonomi, Administratë:**

Matematikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjeografi

- Juridik dhe Administratë:**

Gjuhe shqipe dhe letërsi, Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi

- Tregti, Hotelieri dhe Turizëm:**

Gjuhë shqipe dhe letërsi Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi

- Shkollat Artistike:**

Gjuhë amtare dhe letërsi Edukat qytetare, Art, Muzikë

- Drejtimi pedagogjik - profili bashkëpunëtor muzikor:**

Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe testin kombëtar;

- Drejtimi instrumental:**

Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VII); në klasën e VII të shkollës së muzikës mund të regjistrohen vetëm nxënësit që kanë përfunduar shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VI).

Të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në klasën e dhjetë, duhet t'i nënshtrohen provimit pranues nga komisioni i shkollës.

### 2. Kriteri i suksesit të notave në lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:

- Shkollat e Shëndetësisë** – Mesatarja e lëndëve: fizikë, kimi, biologji dhe gjuhë amtare së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji)

$$\frac{\text{mes(Kimi)} + \text{mes(Biologji)} + \text{mes(Fizikë)} + \text{mes(Gjuhë shqipe)}}{4} \geq 4$$

- Renditja e lëndëve me prioritet sipas profileve në IAAP

#### I. Shëndetësi, Bujqësi dhe Veterinari

- Shkencat natyrore - 25 25 x 0.8 = 20 pikë
  - Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze - 25 25 x 0.4 = 10 pikë
  - Matematikë dhe Informatikë - 25 25 x 0.3 = 7.5 pikë
  - Shkencat shoqërore - 25 25 x 0.1 = 2.5 pikë
- Totali = 40 pikë**

#### II. Makineri, Elektroteknikë, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë dhe Komunikacion, Kimi – Teknologji

- Matematikë dhe Informatikë - 25 25 x 0.8 = 20 pikë
  - Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze - 25 25 x 0.4 = 10 pikë
  - Shkenca natyrore - 25 25 x 0.3 = 7.5 pikë
  - Shkenca shoqërore - 25 25 x 0.1 = 2.5 pikë
- Totali = 40 pikë**

#### III. Ekonomi

- Matematikë dhe Informatikë - 25 25 x 0.8 = 20 pikë
  - Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze - 25 25 x 0.4 = 10 pikë
  - Shkenca shoqërore - 25 25 x 0.3 = 7.5 pikë
  - Shkencat natyrore - 25 25 x 0.1 = 2.5 pikë
- Totali = 40 pikë**

#### IV. Juridik

- Shkencat shoqërore - 25 25 x 0.8 = 20 pikë
  - Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze - 25 25 x 0.4 = 10 pikë
  - Matematikë dhe Informatikë - 25 25 x 0.3 = 7.5 pikë
  - Shkenca natyrore - 25 25 x 0.1 = 2.5 pikë
- Totali = 40 pikë**

#### V. Tregti, Hotelieri dhe Turizëm

- Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze - 25 25 x 0.8 = 20 pikë
  - Shkenca shoqërore - 25 25 x 0.4 = 10 pikë
  - Matematikë dhe Informatikë - 25 25 x 0.3 = 7.5 pikë
  - Shkenca natyrore - 25 25 x 0.1 = 2.5 pikë
- Totali = 40 pikë**

#### VI. Shkollat Artistike

- Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze - 25 25 x 0.8 = 20 pikë
  - Shkenca shoqërore - 25 25 x 0.4 = 10 pikë
  - Matematikë dhe Informatikë - 25 25 x 0.3 = 7.5 pikë
  - Shkenca natyrore - 25 25 x 0.1 = 2.5 pikë
- Totali = 40 pikë**

## KONKURSI PËR QENDRAT E KOMPETENCËS 2026/27

Vendi	Shkolla	Drejtimit	Profillet	Paralelet	Nr.Nxënësve		
Prishtinë	"Shtjefën Gjeçovi"	Makineri, prodhim dhe ndërtimtari	Dirigjimi kompjuterik i makinave	1	24		
			Metalpunues-DUAL	1	24		
			Automekanik-DUAL	2	48		
			Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit	2	48		
			Mekatronikë	1	24		
			Trafik rrugorë	1	24		
		Art	Konfeksion	2	48		
			Rrobaqepës	1	24		
		Shërbime	Floktari-DUAL	1	20		
			Esteticient-DUAL	1	20		
		Gjithsej: "Sh. Gjeçovi"				<b>14</b>	<b>328</b>
		Prizren	"11 Marsi"	Teknologji e informacionit dhe komunikimit	Telekomunikacion	1	24
Informatikë	1				24		
Dizajn softueri	2				48		
Teknik i sistemeve të TIK-ut	1				24		
Makineri, prodhim dhe ndërtimtari	Instalues elektrik-DUAL						
	Mekatronikë			1	24		
	Trafik rrugorë			1	24		
	Automekanik-DUAL			2	48		
	Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit			4	96		
	Metalpunues-DUAL			1	24		
	Arkitekturë			1	24		
	Ndërtimtari			1	24		
Art	Dizajn grafik			2	48		
	Dizajn enterieri			1	24		
	Dizajn tekstil dhe veshje			3	72		
Gjithsej: "11 Marsi" (shq.)				<b>23</b>	<b>552</b>		
	Qendra e Kompetencës			Makineri, prodhim dhe ndërtimtari	Automekanik	1	24
					Teknologji e informacionit dhe komunikimit	Instalues elektrik	
		Art	Dizajn tekstil dhe veshje	1	24		
			Gjithsej: Gj. boshnjake				<b>1</b>
		Art	Mësimi në gjuhën turke				
			Mekatronikë	1	24		
		Gjithsej: Gj. turke				<b>1</b>	<b>24</b>
		Gjithsej: "11 Marsi"				<b>27</b>	<b>648</b>
			Qendra e Kompetencës	Ekonomi, administrim dhe juridik	Financa	1	24
					Marketing	1	24
				Shërbime	Tregti me pakicë dhe shumicë-DUAL	1	24
					Udhëheqës i udhëtimeve dhe grupeve turistike	1	24
Esteticient-DUAL	1				24		
Asistent i mikpritjes hoteliere-DUAL	1				24		
Teknologji e informacionit dhe komunikimit	Floktari-DUAL			1	24		
	Asistent në organizimin e ngjarjeve			1	24		
	Teknik i informatikës së biznesit			1	24		
Gjithsej: Qendra e Kompetencës				<b>9</b>	<b>216</b>		
Ferizaj	Qendra e Kompetencës	Shëndetësi	Bashkëpunëtor profesional i infermierisë	1	24		
			Asistent i fizioterapisë	1	24		
			Teknik i laboratorit mjekësor	1	24		
			Teknik dentar	1	24		
			Teknik i farmacisë	1	24		
			Teknik i optikës	1	24		
			Asistent i sigurisë ushqimore dhe dietave	1	24		
			Gjithsej: QK				<b>7</b>
Skenderaj	Qendra e Kompetencës	Makineri, prodhim dhe ndërtimtari	Ndërtues i konstruksioneve të thata/ Ngjyrëpunues- llakpunues	1	24		
			Zdrukthëtarë dhe punë kulmi/ Llamarinë punues dhe punues metali	1	24		
			Arkitekturë	1	24		
			Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit	2	48		
			Instalues elektrik	1	24		
			Murator dhe punëtor të ngjashëm-DUAL	1	18		
		Art	Kuzhinier/Asistent i mikpritës hoteliere - DUAL	1	24		
			Dizajn tekstil dhe veshje	1	24		
		Gjithsej: Qendra e Kompetencës				<b>9</b>	<b>210</b>
		Malishevë	Qendra e Kompetencës	Administratë dhe shërbime juridike	Nëpunës i Administratës dhe Shërbimeve të Zyrës	1	24
Nëpunës për Banka, Financa dhe Sigurime	1				24		
Ekonomi, administrim dhe juridik	Nëpunës i Marketingut dhe Shitjes			2	48		
	Tregtar me pakicë dhe shumicë-DUAL			1	24		
Shërbime	Kuzhinier - DUAL			1	24		
	Teknologji e informacionit dhe komunikimit			Teknik i sistemeve të TIK-ut			
Makineri, prodhim dhe ndërtimtari				Instalues elektrik	1	24	
	Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit			1	24		
Art	Dizajn tekstil dhe veshje	1	24				
	Gjithsej: QK				<b>10</b>	<b>240</b>	





Bazuar në nenin 38 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Paneli për përzgjedhjen e dy anëtarëve joekzekutivë të Bordit të Bankës Qendrore, me datën 06 Korrik 2026 publikon:

### Shpallje

Për plotësimin e dy pozitave për anëtarë joekzekutivë të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

#### 1. Profili i kërkuar i kandidatëve:

- Të jetë shtetas/e i/e Kosovës;
- Të jetë me integritet;
- Të ketë diplomë universitare për studimet themelore;
- Të ketë minimum dhjetë (10) vite përvojë profesionale ose akademike në fushat e ekonomisë, financave, bankave, kontabilitetit apo çështjeve juridike;
- Të ketë njohuri në zhvillimin dhe implementimin e politikave të rëndësishme të ndërlidhura me misionin, objektivat dhe detyrat e BQK-së;
- Të përmbushë kërkesat nga neni 40 i Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;

#### 2. Përparësi do të kenë kandidatët që kanë:

- Përvojë në qeverisje korporative, në pozita të larta drejtuese ose vendimmarrëse;
- Përvojë si anëtar bordi, komitete ose organe kolegjinale;
- Certifikime profesionale relevante të ndërlidhura me mandatin e BQK-së;
- Njohuri të gjuhës angleze dhe gjuhëve tjera.

#### 3. Dokumentet e kërkua për pozitën në fjalë:

- CV;
- Letër motivuese ku paraqitet qartazi ndërlidhja e profilit të kandidatit/es me kërkesat e pozitës së shpallur;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja valide e ID-së (e lëshuar nga institucionet e Republikës së Kosovës);
- Diplomat e noterizuara, ndërsa për diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës, edhe nostrifikimet e tyre të noterizuara në Republikën e Kosovës;
- Dëshmi mbi përvojën e punës (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar përvojën e punës, pa cënuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Certifikatën nga Gjykata kompetente, e cila dëshmon se kandidati/ja nuk ka qenë asnjëherë subjekt i ndonjë vepre penale (certifikatë kjo jo më e vjetër se 3 muaj - mund të jetë e lëshuar elektronikisht);
- Deklaratën nën betim të nënshkruar, (e bashkëngjitur në shpallje);
- [www.bqk-kos.org/shpalljet/konkurse-te-punes/](http://www.bqk-kos.org/shpalljet/konkurse-te-punes/)
- Dëshmi mbi plotësimin kërkesave të preferueshme (përparësisë) sipas pikës 2 të kësaj shpalljeje;
- Rekomandimet dhe referencat e mundshme (opsionale).

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e lartcekur përmes email adresës vijuese: [paneli@bqk-kos.org](mailto:paneli@bqk-kos.org)

Dokumentacioni i pakompletuar ose i dorëzuar pas afatit nuk do të shqyrtohet.

Afati i fundit për aplikim është **27 korrik 2026**.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur nga ana e Panelit do të ftohen për intervistë.

Emërimi do të jetë për një mandat pesëvjeçar duke filluar nga data e emërimit.

Lista e kandidatëve që kualifikohen nga ana e Panelit do t'i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës i cili do të përzgjedhë dy individë. Miratimi dhe emërimi për këtë pozitë do të bëhet nga Presidenti/ja i/e Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 84.27 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 38.2 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Emrat e kandidatëve të cilët Paneli i dërgon në Kuvendin e Kosovës dhe Qeveri (për t'u përzgjedhur) do të publikohen në faqen e internetit të Bankës Qendrore. Me aplikimin për pozitën e anëtarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore, konsiderohet se kandidati/ja ka dhënë pëlqimin për publikimin në fjalë.



Na osnovu člana 38 Zakona br. 03/L-209 o Centralnoj banci Republike Kosovo, Panel za izbor dva neizvršna člana Upravnog odbora Centralne banke, od 06. jula 2026. godine, objavljuje:

### Oglas

Za popunjavanje dve pozicije za neizvršne članove Upravnog odbora Centralne banke Republike Kosovo

#### 1. Potreban profil kandidata/kandidatkinje:

- Da je građanin/državljanica Kosova;
- Da je osoba od integriteta;
- Da poseduje univerzitetsku diplomu osnovnih studija;
- Da ima najmanje deset (10) godina stručnog ili akademskog iskustva u oblastima ekonomije, finansija, bankarstva, računovodstva ili pravnih pitanja;
- Da poseduje znanje o razvoju i sprovođenju važnih politika vezanih za misiju, ciljeve i zadatke CBK;
- Da ispunjava zahteve propisane članom 40 Zakona br. 03/L-209 o Centralnoj banci Republike Kosovo;

#### 2. Prednost će biti data kandidatima koji imaju:

- Iskustvo u korporativnom upravljanju, na višim rukovodećim ili pozicijama donošenja odluka;
- Iskustvo kao član odbora, komiteta ili kolegijalnih tela;
- Relevantne stručne sertifikacije vezane za mandat CBK;
- Znanje engleskog i drugih jezika.

#### 3. Potrebna dokumenta za objavlvenu poziciju:

- CV;
- Propratno pismo koje jasno pokazuje vezu između profila kandidata/kandidatkinje i zahteva oglasene pozicije;
- Dokaz o identitetu/važeća kopija lične karte (izdata od strane institucija Republike Kosovo);
- Overene diplome, dok je za diplome stečene van Republike Kosovo potrebna i njihova nostrifikacija, overena u Republici Kosovo;
- Dokaz o radnom iskustvu (kopije ugovora o radu, potvrde poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe kao dokaz o radnom iskustvu, uz poštovanje važećih propisa o zaštiti podataka o ličnosti).
- Potvrda nadležnog suda kojom se dokazuje da kandidat/kandidatkinja nikada nije bio/la osuđen/a za krivično delo (ova potvrda ne sme biti starija od 3 meseca - može se izdati elektronski);
- Potpisana izjava pod zakletvom (priložena uz oglas); [www.bqk-kos.org/shpalljet/konkurse-te-punes/?lang=sr](http://www.bqk-kos.org/shpalljet/konkurse-te-punes/?lang=sr)
- Dokaz o ispunjenosti poželjnih uslova (prednosti) iz tačke 2 ovog oglasa;
- Preporuke i moguće reference (opciono).

Zainteresovani kandidati treba da dostave gore navedenu dokumentaciju putem sledeće imejl adrese: [panel@bqk-kos.org](mailto:panel@bqk-kos.org)

Nepotpuna dokumentacija ili dokumentacija dostavljena nakon roka neće biti razmatrana.

Krajnji rok za podnošenje prijave je **27. jul 2026**.

Samo kandidati koje odabere Panel biće pozvani na razgovor.

Imenovanje će se izvršiti na mandat od pet godina, počev od dana imenovanja.

Lista kandidata koje je kvalifikovao Panel biće poslata Skupštini Republike Kosovo, koja će izabrati dve osobe. Odobrenje i imenovanje za ovu poziciju izvršiće predsednik/predsednica Republike Kosovo u skladu sa članom 84.27 Ustava Republike Kosovo i članom 38.2 Zakona br. 03/L-209 o Centralnoj banci Republike Kosovo

Imena kandidata koje Panel pošalje Skupštini Kosova i Vladi (radi izbora) biće objavljena na web stranici Centralne banke. Podnošenjem prijave za poziciju neizvršnog člana Odbora Centralne banke smatra se da je kandidat dao saglasnost za navedena objavljivanja.

**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992

